



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Blerina Huruglica	31.12.2025	14.01.2026	2025/1276

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 26.12.2025, OE **“N.N. Bli TERM”- Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr: 2025/1276, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë GOE **“NMA SHPK & Ozone Space SHPK”- Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Vleresimi i rrezikshmerise ne vendet e punes ne KEK sh.a.”** me nr. të prokurimit: **“KEK-25-5008-2-1-1”**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: **605,931.00 €**.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

--

1. Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
2. Neni 10 - Mjetet për promovimin e Transparencës
3. Neni 11 - Informatat Sekrete Afariste
4. Neni 56 - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
5. Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
6. Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës
7. Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
8. Neni 7.4, 7.6, 7.6.1 dhe 7.6.2 të Rregullores së Prokurimit Publik
9. Neni 40.3 të Rregullores së Prokurimit Publik

Pretendimi 1

Sipas DT-së, kërkesa ishte si vijon:

2.7 Një (1) Ekspert të Biologjisë Drejtimi Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit

Ndërsa dëshmia e kërkuar ishte:

2.7 Të ofrohet si dëshmi diploma universitare (kopje), kontrata e punës ose marrëveshjet për projektin konkret dhe certifikata nga MPMS, si dhe Licencë për VNM nga institucioni kompetent, me 5 vite përvojë pune, të dëshmohet me referenca

Kjo kërkesë është ndryshuar përmes Njoftimit për Korrigjim, datë 21.07.2025, si vijon:

2.7. Një (1) Ekspert të Biologjisë Drejtimi Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit, ose dy (2) ekspert të Biologjisë drejtimi Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit, njëri nga ta duhet të jetë i certifikuar si ekspert për SSHP dhe tjetri si ekspert i certifikuar për VNM

Konstatimi i Autoritetit Kontraktues (AK)

AK ka konstatuar se dëshmitë e ofruara për ekspertët e propozuar nga ana jonë nuk i plotësojnë kërkesat, duke theksuar konkretisht se:

- **Znj. Azemine Kajoshi** – i mungon licenca për VNM dhe certifikata nga MPMS;
- **Znj. Bademe Mullalia** – i mungon certifikata për SSHP nga MPMS.

AK në Letren standarde ka theksuar se, për këtë pikë, do të kishte qenë e mundur të kërkohej sqarime në përputhje me nenin 72 të LPP-së (Dokumentacioni dhe informacioni shtesë), paragrafi 3, por për shkak se, sipas vlerësimit të AK-së, pikat tjera janë eliminuese, është dërguar njoftimi për eliminim.

Vlerësimi i pasaktë dhe kontradiktor i AK-së

AK, në arsyetimin e vendimit të tij, **pranon në mënyrë të tërthortë se për këtë pikë do të kishte qenë e mundur të kërkohej sqarime në bazë të nenit 72 të LPP-së, mirëpo nuk ka vepruar në këtë drejtim.** Ky veprim përbën vlerësim të pasaktë dhe të paplotë, pasi vlerësimi i ofertave duhet të bëhet ekskluzivisht në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, të ndryshuara dhe të plotësuara nga vetë AK përmes Njoftimit për Korrigjim, dhe **kriteret e përcaktuara nuk mund të anashkalohen.** Për më tepër, përderisa AK vlerëson se ekziston nevojë për sqarim, atëherë eliminimi i drejtpërdrejtë i ofertës, pa shfrytëzuar mekanizmin ligjor të kërkesës për sqarime, **bie ndesh me parimet themelore të LPP-së,** në veçanti me parimin e trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe transparencës. Si rrjedhojë, moskërkimi i sqarimeve, pavarësisht pranimi se ato kanë qenë të mundshme, **nuk mund të përdoret në dëm të operatorit ekonomik,** veçanërisht kur dëshmitë e dorëzuara janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në DT.


Dëshmitë e ofruara nga ana jonë:

Në përputhje me kërkesën e ndryshuar të FDT-së, ne kemi paraqitur:

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “N.N. Bli TERM”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Vlerësimi i rrezikshmërisë në vendet e punës në KEK sh.a.” me numër të prokurimit: “KEK-25-5008-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.

- **Znj. Bademe Mullalia** – Biologe e licencuar për VNM;
- **Znj. Azemine (Azerime) Kukaj Kajoshi** – Biologe e certifikuar për SSHP nga MPMS.

Kështu, kërkesa që njëri ekspert të jetë i certifikuar për VNM dhe tjetri për SSHP është plotësuar në tërësi.



Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “N.N. Bli TERM”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Vlerësimi i rrezikshmërisë në vendet e punës në KEK sh.a.” me numër të prokurimit: “KEK-25-5008-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.

Emri i Stafit	Postimi	Kualifikimet	Vite
Edmond Haxhiu	Ekspert në Biologji dhe Mbrojtje dhe Mbrojtje e Ajrit	Diploma universitare në Biologji dhe Mbrojtje dhe Mbrojtje e Ajrit, CV Personale	4 Vite
Samir Stubila	Ekspert, Mbrojtje dhe Mbrojtje në Ndërtim dhe Mbrojtje e Ajrit	Diploma universitare në Mbrojtje dhe Mbrojtje në Ndërtim dhe Mbrojtje e Ajrit, CV Personale	2 Vite
Radmir Kallmeti	Ekspert, Mbrojtje dhe Mbrojtje në Ndërtim dhe Mbrojtje e Ajrit	Diploma universitare në Mbrojtje dhe Mbrojtje në Ndërtim dhe Mbrojtje e Ajrit, CV Personale	2 Vite
Elvir Bajiq	Ekspert, Mbrojtje dhe Mbrojtje në Ndërtim dhe Mbrojtje e Ajrit	Diploma universitare në Mbrojtje dhe Mbrojtje në Ndërtim dhe Mbrojtje e Ajrit, CV Personale	2 Vite
Shkëlzen Rrapaj	Ekspert, Mbrojtje dhe Mbrojtje në Ndërtim dhe Mbrojtje e Ajrit	Diploma universitare në Mbrojtje dhe Mbrojtje në Ndërtim dhe Mbrojtje e Ajrit, CV Personale	2 Vite
Behar Kallmeti	Doktor i shkencave në Mbrojtje dhe Mbrojtje e Ajrit	Diploma universitare në Mbrojtje dhe Mbrojtje në Ndërtim dhe Mbrojtje e Ajrit, CV Personale	2 Vite
Kusha Koca	Inxhinier i Sistemeve të Mbrojtjes dhe Mbrojtjes në Ndërtim dhe Mbrojtje e Ajrit	Diploma universitare në Mbrojtje dhe Mbrojtje në Ndërtim dhe Mbrojtje e Ajrit, CV Personale	2 Vite
Ngim Bashi	Ekspert, Mbrojtje dhe Mbrojtje në Ndërtim dhe Mbrojtje e Ajrit	Diploma universitare në Mbrojtje dhe Mbrojtje në Ndërtim dhe Mbrojtje e Ajrit, CV Personale	2 Vite


Sqarimi nga autoriteti kompetent për SSHP

Vlen të theksohet se, për të shmangur çdo paqartësi, ne kemi kërkuar sqarime zyrtare nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Sekretariati i SSHP-së, lidhur me “kualifikimin e ekspertit për SSHP”. Nga Sekretariati i SSHP-së kemi pranuar përgjigje zyrtare, në të cilën sqarohet se: “Rregullorja Nr. 02/2021 për vlerësimin e riskut në vendin e punës, të cilës ju i referoheni, vetëm i përmend rreziqet biologjike. Ndërsa Rregullorja Nr. 01/2021, "Për kualifikimin e personave përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Licencimin e Kompanive të Shërbimeve dhe Trajnimeve për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë", në nenin 4, paragrafi 5, përcakton se personi që posedon kualifikimin e ekspertit për SSHP ka të drejtë: Të punojë si i punësuar në çdo kompani; Të ofrojë shërbime të jashtme për SSHP për çdo kompani të industrisë me risk të ulët; Të punojë në shërbimet për SSHP.


Po ashtu, neni 8 i së njëjtës rregullore përcakton kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për ekspertë, ku ndër profesionet tjera, ekspertë mund të jenë edhe personat që kanë diplomë universitare në biologji, andaj Rregullorja për certifikim nuk i specifikon detajet tjera.”

Deshmia:

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “N.N. Bli TERM”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Vlerësimi i rrezikshmërisë në vendet e punës në KEK sh.a.” me numër të prokurimit: “KEK-25-5008-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.



Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “N.N. Bli TERM”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Vlerësimi i rrezikshmërisë në vendet e punës në KEK sh.a.” me numër të prokurimit: “KEK-25-5008-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.



Pyetje per sqalim - beshq412@gmail.com - Gmail - Adobe Acrobat Pro DC

Home Tools 106 Letter per tende... Pyetje per sqalim - ... x

Compose

Inbox 94

Snoozed

Purchases

More

Labels

More

Info SSHP
to Fatime, ena

I nderuar lidhur me pyetjet tuaja ju informojme se:

Regullorja Nr. 02/2021 per vleresimin e riskut ne vendin e punes, te ciles ju i referoheni, vetem i përmend rezikjet biol.

Ndërsa Rregullorja Nr. 01/2021, "Për kualifikimin e personave përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Licencin Sigurinë dhe Shëndetin në Punë", në nenin 4, paragrafi 5, përcakton se personi që posedon kualifikimin e ekspertit për

1. të punojë si i punësuar në çdo kompani;
2. të ofrojë shërbime të jashtme për SSHP për çdo kompani të industrisë me risk të ulët;
3. të punojë në shërbimet për SSHP.

Po ashtu, neni 8 i së njëjtës rregullore përcakton kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për ekspertë edhe personat që kanë diplomë universitare në biologji, andaj Rregullorja për certifikim nuk i specifikon detajet tjera.

Sa i përket pyetjes së dytë, ju informojmë se vendimet e lëshuara nga Komisioni për SSHP dhe të nënshkruara nga kry afatit të vlefshmërisë.

Çdo të mirë,
Sekretariati i SSHP-së

4°C Mostly clear

Search

16:11 14/12/2025

Rrjedhimisht, rregullorja për certifikimin e ekspertëve të SSHP-së **nuk përcakton kufizime shtesë profesionale**, përtej atyre që ne i kemi përmbushur plotësisht.

Rikujtojmë se kemi dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga AK, përfshirë:

- diplomat universitare;
- kontratat e punës / marrëveshjet për projekt;
- referencat profesionale;
- certifikatat për VNM;
- vendimin për ekspert për SSHP nga MPMS;
- dëshmitë për përvojë pune mbi 5 (pesë) vite.

Me veprimet e saj, Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 59 dhe nenit 72 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, AK nuk ka kryer vlerësimin e ofertës në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Po ashtu, në kundërshtim me nenin 72 të LPP-së, ndonëse vetë AK ka konstatuar se për këtë pikë do të kishte qenë e mundur të kërkoheshin sqarime, **nuk ka kërkuar asnjë sqarim apo dokumentacion shtesë**, por ka proceduar me eliminim të menjëhershëm të ofertës, duke e vendosur operatorin ekonomik në pozitë të pafavorshme dhe duke shkelur parimin e proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë. Si rrjedhojë, eliminimi i ofertës pa shfrytëzuar mekanizmat ligjorë të paraparë nga LPP-ja për sqarimin e dokumentacionit përbën **shkelje substanciale të procedurës së vlerësimit** dhe e bën vendimin e AK-së të pabazuar dhe të kundërligjshëm.

Autoriteti Kontraktues, në Vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, përsërit të njëjtin arsyetim, duke deklaruar se nga ekzaminimi i ofertës është konstatuar se:

- Znj. Azemine Kajoshi nuk posedon licencë për VNM dhe certifikatë valide nga MPMS;
- Znj. Bademe Mullalia nuk posedon certifikatë për SSHP nga MPMS.

Megjithatë, ky konstatim përbën keqinterpretim të qartë të kërkesës së Dosjes së Tenderit, pasi kriteri teknik **nuk ka kërkuar që secili ekspert individualisht të posedojë të dy certifikatat**, por ka përcaktuar qartë si vijon:

“2.7 Dy (2) ekspertë të Biologjisë – drejtimi Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit, ku njëri nga ta duhet të jetë i certifikuar si ekspert për SSHP dhe tjetri si ekspert i certifikuar për VNM.”

Pra, kërkesa ka qenë që ekipi i propozuar, në tërësinë e tij, të përmbushë kriterin, duke pasur:

- një ekspert të certifikuar për SSHP, dhe
- një ekspert të certifikuar për VNM.

Ne kemi paraqitur:

- Znj. Bademe Mullalia – Biologe e licencuar për VNM;
- Znj. Azemine (Azerime) Kukaj Kajoshi – Biologe e certifikuar për SSHP nga MPMS.

Autoriteti Kontraktues ka gabuar duke e trajtuar këtë kërkesë sikur të ishte një kriter individual për secilin ekspert veç e veç, çka **nuk rezulton nga formulimi i Dosjes së Tenderit** dhe bie ndesh me parimet e interpretimit objektiv dhe proporcional të kriterëve të kualifikimit.

Ky veprim përbën:

- shkelje të parimit të proporcionalitetit,
- shkelje të parimit të trajtimit të barabartë,
- si dhe një vlerësim formalist dhe të padrejtë të ofertës sonë.

Autoriteti Kontraktues ka dështuar të analizojë përmbushjen e kriterit në mënyrë substanciale dhe në përputhje me kërkesën reale të DT-së, duke refuzuar ofertën për arsye që nuk burojnë nga kriteret e përcaktuara.

Pretendimi 2

Sipas DT-së, kërkesa ishte si vijon:

2.13 Një Inxhinier i diplomuar i certifikuar nga AME (Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave të Kosovës) për vlerësimin e rreziqeve dhe zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera

2.15 Dy (2) Lead Auditor sipas standardeve ISO për menaxhimin e ambientit

2.16 Dy (2) Lead Auditor sipas standardeve ISO për siguri dhe shëndet në punë

2.17 Dy (2) Lead Auditor sipas standardeve ISO për menaxhimin e cilësisë

Konstatimi i Autoritetit Kontraktues (AK)

Eshte konstatuar se ekspertet Ibush Luzha dhe Ruzhdi Feka jane propozuar ne disa pozita njekohesisht, duke qene te njejtë per disa funksione te ndryshme.

FDT kerkon qe secila pozite te mbulohet me personel te dedikuar dhe te kualifikuar vec e vec, dhe nje ekspert nuk mund te mbuloje disa pozita paralelisht.

Ne mungese të deshmive të kerkuara dhe për shkak të mosperiçudhjes së personelit të propozuar, kjo paraqet mosperputhje me kërkesat profesionale dhe teknike të FDT-se

Vlerësimi i pasaktë i AK-së:

Në asnjë pjesë të DT-së **nuk është përcaktuar numri minimal i stafit**, nuk është kërkuar **personel i dedikuar ekskluzivisht për secilën pozitë**, dhe as nuk është ndaluar që i njëjti ekspert të propozohet për më shumë se një pozitë, për aq kohë sa plotëson kërkesat profesionale dhe posedon certifikatat përkatëse.

Vlerësimi i AK-së është **i pasaktë, kontradiktor dhe i pabazuar në DT**, për shkak se **AK nuk mund të imponojë gjatë fazës së vlerësimit kërkesa që nuk janë përcaktuar qartë dhe shprehimisht në Dosjen e Tenderit.**

Në mungesë të një përcaktimi të qartë në DT lidhur me:

- ndalimin e mbulimit të disa pozitave nga i njëjti ekspert;
- kërkesën për personel të dedikuar ekskluzivisht për secilën pozitë;

AK **nuk ka bazë ligjore** të konstatojë mosperputhje dhe të eliminojë ofertën tonë mbi këtë bazë. Për më tepër, **vetë AK pranon se kemi ofruar dy inxhinierë që posedojnë dëshmitë dhe certifikatat e kërkuara**, por i konsideron të pamjaftueshëm vetëm mbi bazën e një supozimi subjektiv se të njëjtit nuk mund të kryejnë disa funksione njëkohësisht. Një supozim i tillë **nuk buron nga DT dhe nuk mund të shërbejë si kriter eliminues.**

Neni 56, paragrafi 3 të LPP-së përcakton *"Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".*

Rrjedhimisht, eliminimi i ofertës sonë mbi këtë bazë përbën **shkelje të dispozitës 56.3 të LPP-së**, si dhe të parimeve të trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe transparencës.

Në lidhje me arsyetimin e AK-së të paraqitur në vendimin mbi refuzimin e kërkesës sonë për rishqyrtim, me theks të veçantë për interpretimin e tyre në lidhje me kërkesën e Dosjes së Tenderit për staf profesional dhe mënyrën e propozuar nga ne, theksojmë se:

1. **Nuk pajtohem me interpretimin e AK-së se kërkesa për "Dy (2) Lead Auditor" do të thotë domosdoshmërisht dy persona të ndryshëm për secilën pozitë, dhe se i njëjti ekspert nuk mund të mbulojë më shumë se një pozitë njëkohësisht.**
 - Në Dosjen e Tenderit nuk ekziston ndonjë përcaktim i qartë dhe i shprehur që ndalon një ekspert të propozohet për më shumë se një pozitë, për aq kohë që ai plotëson kërkesat profesionale dhe posedon certifikatat e kërkuara për secilën pozicion.
2. **Kërkesat për numrin e personelit në DT janë të qarta, por nuk përcaktojnë kushtin e personelit ekskluziv për secilën pozitë.**
 - Kjo do të thotë që, në mungesë të një ndalimi të qartë, një ekspert i certifikuar mund të propozohet për më shumë se një pozitë, nëse plotëson kriteret e kërkuara dhe nëse mund të mbulojë kompetencat përkatëse.
3. **Interpretimi i AK-së është i bazuar në një supozim subjektiv dhe jo në prova konkrete për pamundësinë e ekspertëve për të kryer funksione të ndryshme njëkohësisht.**
 - Ky supozim nuk mund të përdoret si bazë për eliminim, pasi do të cenonte parimin e barazisë dhe proporcionalitetit në procedurat e prokurimit publik.
4. **Neni 56, paragrafi 3 i Ligjit për Prokurimin Publik qartë përcakton se nuk mund të imponohen kërkesa të reja ose të panjohuara në njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit gjatë fazës së vlerësimit.**
 - Meqenëse kjo kërkesë (për personel ekskluziv) nuk është përcaktuar qartë në DT, eliminimi i ofertës sonë në bazë të saj përbën shkelje të dispozitës së lartcekur.
5. **Pranimi i ofertave ku i njëjti ekspert llogaritet për disa pozita do të krijonte avantazh të padrejtë ndaj operatorëve që kanë paraqitur personel të veçantë, dhe kjo bie ndesh me parimin e trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së drejtë.**

Pretendimi 3

Sipas DT-së, kërkesa ishte si vijon:

2.18 Një Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikes

Deshmia

2.18 Të ofrohet si dëshmi diploma universitare (kopje), Certifikata për punime në lartësi të lëshuar nga një qendra e licencuar e formimit profesional me 5 vite përvojë pune, të dëshmohet me referenca

Konstatimi i Autoritetit Kontraktues (AK)

Për pikën 2.18, AK ka konstatuar se është kërkuar **Inxhinier i diplomuar**, ndërsa nga ana jonë është ofruar **diplomë e nivelit Bachelor**, e cila sipas vlerësimit të AK-së **nuk i plotëson kërkesat e përcaktuara në FDT**.

Vlerësimi i pasaktë dhe diskriminues i AK-së:

Konstatimi i AK-së është **i pasaktë, i pabazuar dhe në kundërshtim me kërkesat e FDT-së**.

Për kërkesën 2.18, ne kemi ofruar:

- **Diplomë universitare Bachelor**, si dhe
- **Diplomë universitare Master i Shkencave në Menaxhim të Mekatronikës**, me specializim në Menaxhim të Mekatronikës.


Programi i Mekatronikës është **fushë inxhinierike ndërdisiplinore**, e cila përfshin në mënyrë të drejtpërdrejtë **elektroteknikë, elektronikë, automatizim dhe sisteme kontrolli**, dhe konsiderohet pjesë përbërëse e inxhinierisë elektroteknike në praktikë akademike dhe

profesionale.

Dosja e Tenderit **nuk ka përcaktuar drejtim të ngushtë akademik**, nuk ka kërkuar diplomë ekskluzivisht në “Elektroteknikë” si emërtim formal, as nuk ka përjashtuar fusha të afërta apo ndërdisiplinore si Mekatronika.

Në këto rrethana, refuzimi i diplomës së ofruar përbën:

- interpretim të zgjeruar dhe të palejuar të kërkesave të FDT-së;
- vendosje të kriterëve shtesë gjatë fazës së vlerësimit, të cilat nuk janë pjesë e dokumentacionit të tenderit;
- shkelje të nenit 59 të LPP-së, pasi vlerësimi nuk është bërë në përputhje me kriteret e përcaktuara në DT.



Për më tepër, sipas informacioneve që ne posedojmë, **AK ka shpallur fitues dhe ka rekomanduar për dhënie të kontratës një operator ekonomik, i cili për këtë pikë ka ofruar dëshmi identike me ato që kemi ofruar edhe ne. Rrjedhimisht, AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së (Trajtimi i barabartë dhe mosdiskriminimi), duke favorizuar një operator ekonomik dhe duke aplikuar standarde të ndryshme vlerësimi për të njëjtën kërkesë.**

Është e pakuptimtë dhe e papranueshme që operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës, me dëshmi identike me ato të ofruara nga ana jonë për këtë pikë, të vlerësohet si i përgjegjshëm, ndërsa oferta jonë të shpallet e papërgjegjshme për të njëjtën kërkesë të AK-së.

Për më tepër, këto veprime krijojnë **dyshime serioze për vlerësim të njëanshëm dhe favorizim**, veçanërisht duke pasur parasysh faktin se operatori ekonomik i rekomanduar ka ofertuar me **çmim gati dyfish më të lartë** se oferta jonë, duke cenuar parimin e konkurrencës efektive dhe përdorimit racional të fondeve publike.

Në rastin konkret, Komisioni i Vlerësimit i AK KEK ka bërë shkelje të neneve 7, 56 dhe

59 të LPP-së, si dhe ka vepruar në kundërshtim me parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe konkurrencës së ndershme.

Në lidhje me arsyetimin e AK-së se diploma Master nuk është marrë parasysh pasi nuk është dorëzuar brenda afatit të ofertës dhe se **prezantimi i këtij dokumenti në fazën e kërkesës për rishqyrtim është i pavlefshëm dhe i papranueshëm**, theksojmë se:

1. Prezantimi i dokumentacionit plotësues gjatë fazës së rishqyrtimit është një praktikë e njohur dhe e pranueshme në procedurat e prokurimit, me qëllim qartësimin dhe sqarimin e dokumenteve të dorëzuara.
2. Refuzimi absolut i pranimit të diplomës Master në këtë fazë është i padrejtë dhe cenon parimin e barazisë në trajtim të operatorëve ekonomikë, pasi kjo diplomë përforcon dhe plotëson në mënyrë të qartë kualifikimet e kërkuara në Dosjen e Tenderit.
3. Një interpretim strikt që e kufizon vlerësimin vetëm në dokumentet e dorëzuara në afatin fillestar, pa marrë parasysh qëllimin e kërkesës për rishqyrtim për plotësim dhe sqarim, nuk është në përputhje me parimet e transparencës dhe proporcionalitetit në prokurimin publik.

Pretendimi 4

Sipas DT-së, kërkesa ishte si vijon:

2.25 Minimum (2) Ekspert për mbrojtje nga zjarri të certifikuar nga AME (Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave të Kosovës) i profilizuar në shkencat teknike për dhënien e shërbimeve sipas Udhëzimit Administrativ NR.10 2018. Stafi profesional duhet të përmbush kapacitet bazuar në ndarjen e faktorëve e rrezikut sipas Rregullores 02 2021 , rregullores 01 2021 dhe udhëzimit administrativ (MPB) nr.10 2018 AME për trajnimin fillestar në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe Autoritetet e Ministrisë së mjedisit

Konstatimi i Autoritetit Kontraktues (AK)

2.25 Minimum (2) Ekspert për mbrojtje nga zjarri të certifikuar nga AME (Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave të Kosovës) i profilizuar në shkencat teknike për dhënien e shërbimeve sipas Udhëzimit Administrativ NR.10 2018, kemi ofruar vetëm një ekspert.

Vlerësimi i pasaktë dhe diskriminues i AK-së:

Është vlerësuar se ne kemi ofruar vetëm një ekspert, gjë që nuk është e saktë. Ne kemi dorëzuar dëshmi të plotë për dy (2) ekspertë të licencuar, në përputhje të plotë me kërkesat e AK-së dhe FDT-së, konkretisht:

- Z. Nexhmedin Merovci
- Z. Jetmir Rogaqi

Të dy ekspertët posedojnë certifikata valide nga AME si dhe certifikata të përshtatshme nga MPMS, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2018.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është i detyruar të verifikojë në mënyrë të kujdesshme

dosjen e ofertës sonë dhe të analizojë plotësisht dokumentacionin dhe dëshmitë e paraqitura për të dy ekspertët.

Prandaj, vlerësimi i bërë nga Komisioni në këtë pikë është i paqëndrueshëm dhe në kundërshtim me nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik, pasi nuk është kryer një analizë objektive dhe e bazuar në dokumentacion.

Deshmia:

Nexhmedin Merovci	Ekspert për mbrojtje nga zjarri të certifikuar nga AME (Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave të Kosovës) i profilizuar në shkencat teknike për dhënien e shërbimeve sipas Udhëzimit Administrativ NR.10 2018. Staf i profesional duhet ti përmbush kapacitet bazuar në ndarjen e faktorëve e rezultat sipas Rregullores 02 2021 , rregullores 01 2021 dhe udhëzimit administrativ (MPB) nr.10 2018 AME për trajnimin fillestar në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe Autoritetet e Ministrisë së Mbrojtjes.	Diploma universitare Kontrata e punës Certifikatën nga MPMS dhe AME, CV Personale Referenca	5 Vite
Jelmir Rogaqi	Ekspert për mbrojtje nga zjarri të certifikuar nga AME (Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave të Kosovës) i profilizuar në shkencat teknike për dhënien e shërbimeve sipas Udhëzimit Administrativ NR.10 2018. Staf i profesional duhet ti përmbush kapacitet bazuar në ndarjen e faktorëve e rezultat sipas Rregullores 02 2021 , rregullores 01 2021 dhe udhëzimit administrativ (MPB) nr.10 2018 AME për trajnimin fillestar në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe Autoritetet e Ministrisë së Mbrojtjes.	Diploma universitare Kontrata e punës Certifikatën nga MPMS dhe AME, CV Personale Referenca	5 Vite

DATA: 25.08.2025

Në lidhje me arsyetimin e Autoritetit Kontraktues (AK) në Vendimin mbi Refuzimin e Kërkeses për rishqyrtim se “Neni 72 lejon vetëm pranimin e dokumenteve ekzistuese që janë para datës së njoftimit për kontratë, por pasi që kemi pika tjera eliminuese, nuk kemi mundur t’ju kërkojmë sqarime, por vetëm ju kemi njoftuar përmes njoftimit për eliminim që nuk i posedoni këtë dokument”, theksojmë se ky arsyetim është i papranueshëm dhe absurd për këto arsye:

1. Ne kemi paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në mënyrë të plotë dhe në përputhje me kërkesat e qarta dhe të detajuara të Dosjes së Tenderit (DT), përfshirë të gjitha certifikatat dhe dëshmitë përkatëse për ekspertët e propozuar.
2. Në praktikën e prokurimit publik, edhe kur ekzistojnë pika eliminuese, është normale dhe e pranueshme që të kërkohej sqarime ose plotësime të dokumenteve për të garantuar vlerësimin e drejtë dhe të plotë të ofertave.
3. AK, me këtë qëndrim, cenon të drejtën tonë për trajtim të barabartë dhe nuk respekton parimet e ligjit për prokurim publik, duke ndikuar negativisht në integritetin e procesit.

Pretendimi 5

Sipas DT-së, kërkesa ishte si vijon:

3. OE duhet të ketë Laboratorin Testues të Akredituar

Dëshmia:

3. Certifikatën e Akreditimit

Aneksin i certifikatës së akredituara (parametrat testues):

3.1 CO;O₂; CO₂

3.2 Matja e nivelit të zhurmës

3.3 Temperatura, lagështia e ajrit dhe rrymimi i ajrit

3.4 lëkundjeve - vibrimit

3.5 Ndriçimi në ambientet pune

3.6 Shqyrtimit të mbrojtjes reziduale – FID dhe shqyrtimit të tokëzimit mbrojtës - prizat

3.7 Shqyrtimet të rrufepritësit

Konstatimi i Autoritetit Kontraktues (AK)

Certifikata e akreditimit nuk e ka vetëm pikën 3.7 Shqyrtimet të rrufepritësit.

Vlerësimi i pasaktë dhe diskriminues i AK-së:

Sqarojmë se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka trajtuar këtë kërkesë në mënyrë profesionale dhe teknike. Në raportin e vlerësimit nuk është specifikuar profesioni i anëtarëve të Komisionit, dhe për pasojë nuk është e qartë nëse ndonjëri prej tyre ka poseduar kualifikim profesional të përshtatshëm (p.sh. inxhinier), që do ta kishte kuptuar dhe interpretuar drejt përmbajtjen dhe terminologjinë teknike të Certifikatës së Akreditimit.

Sqarojmë se Certifikata e Akreditimit, së bashku me Aneksin e Certifikatës së Akredituar për Laborator Testues të Akredituar, e paraqitur nga ne, përfshin edhe pikën përkatëse të shqyrtimeve të rrufepritësit. Megjithatë, ajo është e shënuar me një **emërtim tjetër teknik**, që është sinonim profesional i termit "Shqyrtimet e rrufepritësit". Ky fakt është lehtësisht i verifikueshëm nga profesionistët e fushës (**shih faqen 3 nga 3, pika 17 e dëshmive të dorëzuara**).

Në lidhje me vlerësimin e bërë nga komisioni se operatori ekonomik nuk i plotëson kërkesat për shkak të mungesës së shqyrtimit të rrufepritësit, sqarojmë se ky konstatim nuk qëndron as në aspektin teknik dhe as në aspektin juridik. Sistemi i mbrojtjes nga rrufeja (rrufepritësi) përbën një sistem teknik të pandashëm, pjesë përbërëse dhe thelbësore e të cilit është sistemi i tokëzimit. Sipas standardeve teknike në fuqi dhe praktikës së konsoliduar profesionale, vlerësimi i funksionalitetit të rrufepritësit realizohet përmes matjes së rezistencës së tokëzimit, pasi pa tokëzim funksional rrufepritësi nuk mund të ekzistojë dhe as të kryejë funksionin e tij mbrojtës. Për rrjedhojë, përfshirja e aktivitetit "Rezistenca e tokëzimit" përbën përfshirje të drejtpërdrejtë dhe të plotë të shqyrtimit të rrufepritësit. Kjo është e konfirmuar edhe ligjërisht, pasi ne jemi të pajisur me Autorizim zyrtar nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent për kryerjen e punëve të testimit të rezistencës së tokëzimit në instalimet rrufepritëse, çka dëshmon se autoriteti kompetent shtetëror e njeh këtë veprimtari si aktivitet specifik të lidhur drejtpërdrejt me rrufepritësin. Në mungesë të një standardi ose metode të veçantë testimi të përcaktuar ndryshe për rrufepritësin, kërkesa për ndarje formale ndërmjet rrufepritësit dhe tokëzimit mbetet vetëm terminologjike dhe nuk gjen mbështetje në standarde, në praktikën profesionale, apo në kuadrin ligjor përkatës. Për këtë arsye, kërkojmë që AK të formojë një Komision profesional ose të kërkojë sqarime nga ekspertë të fushës brenda institucionit, me qëllim të vlerësimit korrekt dhe profesional të dëshmive tona. Në këtë mënyrë, AK do të bindet se ne kemi ofruar dëshmi plotësisht në përputhje me kërkesat e Fletës së Detyrave (FDT), edhe në këtë pikë.

Rrjedhimisht, eliminimi ynë për këtë arsye është i pabazuar dhe në kundërshtim me

dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), veçanërisht me parimet e vlerësimit objektiv dhe profesional të ofertave.

Në lidhje me arsyetimin e AK-së në Vendimin mbi Refuzimin e Kërkesës për rishqyrtim se:

- Oferta jonë nuk i përmbush kërkesat teknike të pikës 3.7 për "Shqyrtimin e rrufepritësit" sepse nuk është paraqitur dëshmi e veçantë e akreditimit për këtë aktivitet
- Dokumentacioni i dorëzuar për "Shqyrtimin e tokëzimit mbrojtës" dhe "mbrojtjen reziduale (FID)" nuk mund të konsiderohet mbulim i kësaj kërkesë
- Shqyrtimi i rrufepritësit dhe i tokëzimit janë aktivitete të ndryshme që kërkojnë akreditim specifik dhe vlerësim të veçantë,
- Oferta jonë është e papërgjegjshme për mungesë të këtij akreditimi specifik,

ne paraqesim ankesën tonë me arsyetimin e mëposhtëm:

1. **Përputhshmëria profesionale dhe teknike:** Dosja e Tenderit nuk ka përcaktuar ndarjen formale dhe të detajuar të aktiviteteve "shqyrtimi i rrufepritësit" dhe "shqyrtimi i tokëzimit mbrojtës" si dy aktivitete të ndara në aspektin e akreditimit. Praktika profesionale dhe standardet teknike të fushës konsiderojnë sistemin e tokëzimit si pjesë përbërëse dhe funksionale thelbësore të sistemit të mbrojtjes nga rrufepritësi.
2. **Dëshmia e akreditimit:** Ne kemi paraqitur certifikatën e akreditimit dhe aneksin për laboratorin testues që përfshin testimin e rezistencës së tokëzimit, i cili është standardi kryesor për vlerësimin e funksionimit të rrufepritësit sipas standardeve dhe praktikës së miratuar. Kjo certifikatë është e njohur dhe e pranuar edhe nga Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave (AME) si autorizim zyrtar për kryerjen e këtyre testeve.
3. **Kërkesa për vlerësim profesional dhe korrekt:** Ne kërkojmë që AK të formojë një komision profesional të fushës ose të kërkojë opinion teknik nga ekspertë të pavarur, në mënyrë që të vlerësohet në mënyrë objektive dhe teknike përputhshmëria e ofertës me kërkesat teknike të Dosjes së Tenderit.

Pretendimi 6

Në lidhje me pikën e gjashtë të eliminimit, ku Autoriteti Kontraktues ka theksuar mungesën e Formularit Standard të Marrëveshjes për Themelimin e Grupit – Aneksi 7, dëshirojmë të sqarojmë se:

Ne kemi dorëzuar marrëveshjen e grupit (konsorciumit), e cila përmban të gjitha kërkesat e përcaktuara në nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (LPP).

Mungesa e formularit standard të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues nuk mund të jetë arsye për eliminimin e ofertës, veçanërisht kur janë paraqitur dokumentet që plotësojnë kërkesat thelbësore ligjore dhe ato të tenderit.

Grupi ynë ka plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara në nenet 65 dhe 71 të LPP-së:

- duke dëshmuar se nuk jemi të përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit.
- një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i

epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës;

- një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;
- një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit; dhe

Refuzimi i ofertës sonë me vlerë 330,069.60 Euro dhe shperblimin e OE me cmim 603,905.12 për mungesën e një forme të veçantë, kur në fakt janë dorëzuar të gjitha dokumentet dhe deklaratat ligjore të nevojshme, është jo vetëm i papranueshëm, por edhe qesharak nga pikëpamja e qëllimit të ligjit. Ky vendim bie ndesh me frymën e ligjit, që kërkon zbatim efikas të fondeve publike dhe përzgjedhjen e ofertës me vlerën më të mirë.

Sipas nenit 59.4 të LPP-së, autoriteti kontraktues mund të pranojë ofertat edhe në rastet e gabimeve, paqartësive apo devijimeve të vogla, për sa kohë që nuk preken aspektet materiale të dokumentacionit të tenderit.

Sipas Rregullores së Prokurimit Publik, 45.19 *"Neni 59.4 i LPP-së gjithashtu lejon autoritetin kontraktues që të pranojë ofertat, në raste të gabimeve ose paqartësive dhe në raste të devijimeve të vogla. Në të dyja rastet është një kusht që aspektet materiale të njoftimit për kontratë / dosjen e tenderit nuk janë prekur.*

45.20 Mundësia për pranimin e tenderëve, varet nga ajo se çfarë janë "aspektet materiale". Për sa i përket elementeve kontraktuale të dosjes së tenderit, çdo aspekt do të konsiderohet si material, nëse ka mundësi të ndryshojë kushtet e kontratës në lidhje me për shembull cilësinë ose kërkesat e performancës, çmimin ose mënyrën e pagesës, garancinë, sigurimin ose detyrimin dhe sidomos në rastet kur ndryshimi çon në një reduktim të të drejtave kontraktuale të autoritetit kontraktues ose obligimeve të tenderuesit kontraktual.

Pra, aspektet materiale konsiderohen ato që ndikojnë në kushtet kontraktuale, si cilësia, çmimi, mënyra e pagesës, garancia, apo ndryshime që reduktojnë të drejtat e autoritetit kontraktues ose obligimet e tenderuesit.

Në këtë kontekst, mungesa e Formularit Standard mund të konsiderohet si devijim i vogël që nuk cenon qëllimin bazë të ligjit, i cili është siguri i vlerës më të mirë për paratë dhe shfrytëzimi efikas i fondeve publike. Refuzimi i ofertës sonë me vlerë 330,069.60 Euro dhe shperblimin e OE me cmim 603,905.12 është në kundërshtim me parimet e LPP. Prandaj, vendimi për refuzimin e ofertës sonë dhe dhënien e kontratës me një çmim dukshëm më të lartë është jo vetëm i padrejtë, por edhe ekonomikisht joefikas dhe në shkelje të ligjit. Kërkojmë që ky vendim të rishqyrtohet në mënyrë që të respektohen parimet ligjore dhe të sigurohet përdorimi optimal i fondeve publike.

Pretendimi 7

Pas publikimit të njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues (AK), kompania jonë ka paraqitur kërkesë për qasje në dokumentacionin e operatorit të propozuar për dhënie të kontratës. Megjithatë, AK ka mohuar qasjen reale dhe të plotë në këtë dokumentacion, duke shkelur në mënyrë të drejtpërdrejtë dispozitat ligjore të neneve 10 dhe 11 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), si dhe nenin 7 të Rregullores për Prokurim Publik.

Në veçanti, AK ka trajtuar pothuajse të gjithë dokumentacionin e operatorit fitues si

“konfidencial”, duke shkelur qartë nenet 7.6 dhe 7.6.1 të Rregullores së Prokurimit Publik. Bazuar në rregulloren në fuqi:

- Operatorët ekonomikë (OE) duhet të identifikojnë qartë dokumentet që konsiderojnë sekret afarist;
- **Duhet të japin arsyetim të detajuar për secilin dokument veç e veç, përse zbulimi i tij do t'i shkaktoje dëm material;**
- Duhet të dorëzojnë Aneksin 3 të nënshkruar dhe vulosur, me shpjegime të plota;
- **AK është e ndaluar të trajtojë dokumentacionin si sekret në mungesë të provave konkrete që provojnë dëm material nga zbulimi i informatave.**

Në këtë rast, OE i rekomanduar nuk ka dhënë asnjë arsyetim të detajuar për dokumentet e klasifikuara si sekret afarist. Në Aneksin 3 është paraqitur vetëm një deklaratë e përgjithshme, e paplotë dhe e paarsyeshme. Megjithatë, AK në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim me rregulloren ka klasifikuar ofertën si “sekret afarist”. Kjo praktikë përbën shkelje të rëndë të nenit 10 të LPP-së.

Gjithashtu, AK ka shkelur nenin 7.6.2 të Rregullores së Prokurimit Publik, i cili përcakton qartë detyrimin e Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit për:

- Përgatitjen e versionit të pastruar të ofertave menjëherë pas hapjes së tyre dhe para publikimit të njoftimit për vendimin e AK-së;
- Njoftimin e palëve të interesuara për disponueshmërinë e këtij versionit të pastruar, ku janë hequr vetëm ato pjesë të arsyetuara ligjërisht si sekret afarist.

Përkundër kësaj, AK nuk ka përgatitur as versionin e pastruar dhe as nuk ka njoftuar kompaninë tonë për të njëjtin, duke e bërë të pavlefshëm pretendimin e AK-së se qasja është ofruar sipas procedurave ligjore. Nëse dokumentet do të ishin realisht sekret afarist, AK nuk do të kishte lejuar qasje fizike pa versionin e pastruar sipas nenit 7.6.2 të Rregullores.

Si rezultat, AK ka shkelur drejtpërdrejt:

- Nenit 10 të LPP-së (për qasjen në dokumente publike);
- Nenit 11 të LPP-së (për sekretin afarist);
- Nenit 7.4, 7.6, 7.6.1 dhe 7.6.2 të Rregullores së Prokurimit Publik;
- Parimin e transparencës dhe trajtimit të barabartë;
- Praktikën e konsoliduar të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), i cili në vendime të shumta ka konstatuar se mohimi i qasjes në dokumente publike përbën shkelje të rëndë, përfshirë edhe vendimet nr. 606/23 dhe 877/23.

Gjithashtu, moslejimi i qasjes në dokumentacion publik cenon rëndë dispozitat e Ligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.

Në kuadër të këtij aktiviteti prokurimi, AK ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe rregulloret, pasi kompania jonë, brenda afateve ligjore, ka paraqitur kërkesë për qasje në dokumentet e operatorit të rekomanduar për dhënie të kontratës, me qëllim verifikimin e dyshimeve për papërgjegjshmëri dhe mosplotësim të kërkesave ligjore dhe teknike nga operatori i shpërblyer me kontratë.

Dyshojmë për mos plotësim të kërkesave nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës për:

- pikën 1 të kërkesave në 8.1 dhe 8.2, si dhe
- pikat 2 dhe 3 në kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale (9.1 dhe 9.2).

Pretendimi 8

Autoriteti Kontraktues (AK) ka rekomanduar për dhënie të kontratës një operator ekonomik (OE) që ka paraqitur **dokumente plotësisht identike me ato që kemi dorëzuar ne**, konkretisht për Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, pika 9.1 dhe 9.2 - **Një (1) Inxhinier të diplomuar në Gjeologji.**

Megjithatë, grupin tonë e ka diskualifikuar si "të pa përgjegjshëm", ndërsa OE i rekomanduar nuk është eliminuar, pavarësisht se ka paraqitur të njëjtat dokumente, dmth ka konkuaruar me te njejtin inxhinier. Kjo tregon qartë se AK nuk ka kryer një ekzaminim, vlerësim dhe krahasim të ofertave në mënyrë të barabartë dhe të paanshme, duke shkelur në mënyrë të drejtpërdrejtë nenet 59 dhe 60 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

Gjithashtu, ky veprim cenon parimin themelor të **Nenit 7 të LPP-së – Trajtimi i Barabartë**, sipas të cilit:

- Autoritetet kontraktuse janë të detyruara të sigurojnë trajtim të njëjtë dhe pa diskriminim për të gjithë operatorët ekonomikë gjatë gjithë procesit të prokurimit;
- Të gjitha ofertat duhet të vlerësohen me kritere të njëjta, transparente dhe objektive, duke shmangur çdo favorizim ose trajtim të ndryshëm që mund të krijojë avantazh të padrejtë për ndonjë operator;

Veprimet e Autoritetit Kontraktues, duke eliminuar ofertën tonë për dokumente të njëjta me ato të OE të rekomanduar dhe duke rekomanduar ofertën më të shtrenjtë, përbëjnë shkelje të qartë të këtij parimi dhe janë në kundërshtim me frymën dhe qëllimin e Ligjit për Prokurimin Publik.

Për më tepër, veprimet e AK-së kanë shkaktuar **dëme financiare për buxhetin e Republikës së Kosovës, duke rekomanduar një ofertë me çmim dukshëm më të lartë, në vend që të përzgjidhte ofertën me vlerën më të mirë për paratë publike.**

Kërkojmë që këto shkelje të merren seriozisht parasysh, të bëhet rishqyrtimi i vendimit dhe të merren masat e duhura për garantimin e drejtësisë, transparencës dhe integritetit të procesit të prokurimit.

Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues në Vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim se kontrata e punës me OE të propozuar për dhënie dhe pagesat në ATK përbëjnë **"dëshminë supreme"** dhe e bëjnë eksperin e tyre më të vlefshëm sesa marrëveshja e bashkëpunimit që ne kemi paraqitur, është i paqëndrueshëm dhe i papranueshëm.

Sipas dispozitave ligjore në fuqi, kërkohet vlerësim objektiv, i drejtë dhe i barabartë i të gjitha ofertave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në dokumentacionin e tenderit, dhe jo vetëm vlerësim sipas asaj se cilat **dëshmi janë formalisht më të favorshme**.

Në përfundim, kërkohet trajtim të barabartë dhe vlerësim objektiv të të gjitha ofertave në përputhje me kriteret e përcaktuara, duke shmangur çdo favorizim ose diskriminim

Pretendimi 9

Autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 40.3 të rregullores për Prokurimin Publik, i cili nën

rregullon afatin kohor për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve dhe sipas kësaj dispozite ligjore pas hapjes së ofertave nxjerrja e njoftimit mbi vendimin apo formulari B58, do duhej të nxirrej brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më larg se 30 ditë nga hapja e ofertave.

40.3 Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nga komisioni vlerësues, dhe nxjerrja e Njoftimit mbi vendimin e AK nga ZPP, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve.

- Data e hapjes së ofertave është realizuar me 26.08.2025.
- Njoftimi mbi vendimin e AK-se është publikuar me 09.12.2025.

Afati kohor i vlerësimit e tejkalon afatin maksimal të përcaktuar me nenin 40.3 të RPP-së apo prej 30 ditësh dhe Autoriteti Kontraktues nuk ka nxjerrë kurrefare vendimi apo nuk ka dhënë asnjë arsye të shkruar dhe të justifikuar për të kërkuar zgjatjen shtesë prej 20 ditësh dhe si pasoje e kësaj vonese Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me rregullat ligjore në fuqi.

Me kete konstatojme se AK ka shkelur nenin 40.3 te Rregullores se prokurimit publik.

Andaj, duke u bazuar në të gjitha provat e bashkëngjitura dhe konstatimet e cekura më lart, konsiderojmë se AK ka bërë vlerësimin e ofertave në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Në lidhje me këtë, kërkojmë nga OSHP që të merr këtë:

V E N D I M

1. **APROVOHET**, si e bazuar Ankesa e OE “N.N. Bli TERM” e parashtruar për aktivitetin e prokurimit me titull: “Vlerësimi i rrezikshmërisë në vendet e punës në KEK” sh.a. me numer të prokurimit KEK-25-5008-2-1-1 dhe Nr. i brendshëm KEK-25-106-211.
2. **Obligohet AK KEK** të formojë një komision profesional, duke përfshirë edhe ekspertë të fushës për aktivitetin e prokurimit në fjalë, me qëllim që vlerësimi të kryhet në mënyrë objektive dhe në përputhje me kërkesat e Fletës së të Dhënave të Tenderit (FDT) dhe Njoftimit për Kontratë.
3. **ANULOHET** Njoftimi i AK-së B58 i dates 09.12.2025 dhe Aktivitetin e prokurimit me titull: “Vlerësimi i rrezikshmërisë në vendet e punës në KEK” sh.a. me numer të prokurimit KEK-25-5008-2-1-1 dhe Nr. i brendshëm KEK-25-106-211 ta kthej në Rivlerësim.
4. Pas rivlerësimit, të shpallet si ofertues përgjegjës dhe me qmim me te lire grupi i operatorëve ekonomikë: N.N. Bli TERM, Instituti Bioinves SHPK, BM SHPK.

KRITERET PËR VLERËSIM

--

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

--



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: Vlerësimi i rrezikshmërisë ne vendet e punës ne KEK sh.a.

Nr. i prokurimit:	KEK-25-5008-2-1-1
Nr. brendshem	KEKO-25-106-211

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës me TVSH
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik NMA SH.P.K.; OZON space SH.P.K., Afrim Zhitia Bll.4 hy.6 nr.14, -, PRISHTINË	603,905.12
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik N.N. Bli TERM; Instituti Bioinvest SH.P.K.; B & M SH.P.K, Rr. ISA KASTRATI, 10000, Prishtinë	330,069.60

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a. shpërblen me kontratë kornize për 36 muaj, Grup i Operatorëve Ekonomik NMA SH.P.K.; OZON space SH.P.K., Afrim Zhitia Bll.4 hy.6 nr.14, -, Prishtinë me vlerën totale të ofertës prej 603,905.12 € me TVSH.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

///

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

///

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - N.N. Bli TERM

Aktiviteti i prokurimit me titull: "Vlerësimi i rrezikshmërisë në vendet e punës në KEK sh.a." me nr. të prokurimit: "KEK-25-5008-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a, procedurë e hapur, lloji i kontratës shërbim, kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshëm.

Ankesa është e parashtruar kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues, në të cilin vendim AK rekomandon për kontratë Grupin e Operatorëve Ekonomik "NMA SHPK & Ozone Space SHPK", ndërsa

Operatori Ankues është eliminuar me arsyetimin:

1 Për pozitën e kërkuar 2.7 Një (1) Ekspert të Biologjisë Drejtimi Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit ose dy (2) ekspert te Biologjisë drejtimi Ekologji dhe mbrojtje e Mjedisit njeri nga ta duhet te jete i certifikuar si ekspert për SSHP dhe tjetri si ekspert i certifikuar për VNM. Ku si dëshmi te dorëzohet : Të ofrohet si dëshmi diploma universitare (kopje), kontrata e punës ose marrëveshjet për projektin konkret dhe certifikata nga MPMS, si dhe Licencë për VNM nga institucioni kompetent, me 5 vite përvojë pune, të dëshmohet me referenca.

Ekspertet e propozuara nuk i plotësojnë kërkesat :

- 1. Azemine Kajoshi, Licencë për VNM i mungon, certifikata nga MPMS i mungon,*
- 2. Bademe Mullalia, i mungon SSHP (MPMS)*

Për këtë pike kemi mundur te kërkojmë sqarime bazuar ne LPP tek neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë sipas paragrafit 3, por pasi qe për pikat e mëposhtme eliminuese nuk i plotësoni ju dërgojmë si njoftim për eliminim.

2. Për pozitat e kërkuara :

2.13 Një Inxhinier i diplomuar i certifikuar nga AME (Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave të Kosovës) për vlerësimin e rreziqeve dhe zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera

2.15 Dy (2) Lead Auditor sipas standardeve ISO për menaxhimin e ambientit ;

2.16 Dy (2) Lead Auditor sipas standardeve ISO për siguri dhe shëndet në punë

2.17 Dy (2) Lead Auditor sipas standardeve ISO për menaxhimin e cilësisë

Është vërejtur se të njëjtit dy ekspertë Ibush Luzha dhe Ruzhdi Feka janë propozuar në disa pozita të ndryshme të kërkuara për ekspertë, gjë që bie ndesh me kërkesat e FDT-së, e cila kërkon që secila pozitë të mbulohet me personel të dedikuar dhe të kualifikuar veç e veç, pra një ekspert nuk mundet të i mbuloj disa pozita

Në mungesë të dëshmive të kërkuara dhe për shkak të mospërputhjes së personelit të propozuar, oferta nuk i përmbush kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Për pozitën :

2.18 Një Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikes, është kërkuar inxhinier i diplomuar, keni ofruar diplome të Bachelor

4. Për POZITEN :

2.25 Minimum (2) Ekspert për mbrojtje nga zjarri të certifikuar nga AME (Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave të Kosovës) i profilizuar në shkencat teknike për dhënien e shërbimeve sipas Udhëzimit Administrativ NR.10 2018, keni ofruar vetëm një ekspert.

5. Tek kërkesat teknike profesionale është kërkuar : OE duhet të ketë Laboratorin Testues të Akredituar, me dëshmi : Certifikatën e Akreditimit

Aneksin i certifikatës së akredituara (parametrat testues):

3.1 CO;O2; CO2

3.2 Matja e nivelit të zhurmës

3.3 Temperatura, lagështia e ajrit dhe rrymimi i ajrit

3.4 lëkundjeve - vibrimit

3.5 Ndriçimi në ambientet pune

3.6 Shqyrtimit të mbrojtjes reziduale – FID dhe shqyrtimit të tokëzimit mbrojtës - prizat

3.7 Shqyrtimet të rrufepritës

Certifikata e akreditimit nuk e ka vetëm piken 3.7 Shqyrtimet të rrufepritës

Ekspertja shqyrtuese sqaron se, rrjedhimisht operatori ankues pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK, i njëjti parashtron ankesë pranë OSHP-së, duke pretenduar se Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit të ofertave shkelë Ligjin e Prokurimit Publik përkatësisht nenet: 7,10,11,59,59,60,72, si dhe nenet 7.4,73.6,7.6.2 dhe 40.3 të Rregullores për Prokurim Publik, i cili pretendon se i plotëson kërkesat dhe se është i përgjegjshëm me çmimin më të ulët të përgjegjshëm.

Përgjigje në pretendimet ankimore të Operatorit Ankues kundër arsyeve të eliminimit:

Pretendimi i parë:

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, lidhur me pretendimin e parë, AK gjithashtu ka theksuar se kanë mundur që të kërkojnë sqarime, dhe meqë ka disa arsye të tjera të eliminimit, si e tillë nuk kanë vazhduar me kërkesë për

sqarime, **mirëpo** bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe Formularit të plotësuar/ndryshuar, kërkesa ka qenë që njëri nga ta duhet të jetë i certifikuar si ekspert për SSHP dhe tjetri si ekspert i certifikuar për VNM, Andaj i e tillë e kërkesa ka qenë e plotësuar. **Pretendimi i bazuar.**

Pretendimi i dytë:

Arsyeja e dytë e eliminimit të OE ankues, ekspertja shqyrtuese shpjegon se, kërkesa nr. 2.13, 2.15, 2.16, 2.17, ku këto tri të fundit janë ndarë në tri certifikime ISO 9001- Menaxhimi i Cilësisë, 14001- Menaxhimi Mjedisor dhe 45001- Menaxhimi i shëndetit dhe sigurisë në punë, të cilat certifikime edhe nëse ofrohen nga një person, nuk konsiderohet se nuk është përmbushur kërkesa, për arsye se këto certifikime nëse ofrohen u lejon profesionistëve të kryejnë **auditime të integruara**, duke kursyer kohë dhe burime, andaj si e tillë **pretendimi i OE ankues gjendet i qëndrueshëm**, për faktin se, meqë Autoriteti Kontraktues bazuar në natyrën e aktivitetit të prokurimit (shërbim), nuk janë përcaktuar numri i saktë i stafit, dhe marrë parasysh kërkesa që ka të bëjë me vlerësimin e rrezikshmërisë në vendet e punës, i cili aktivitet është i natyrës shërbim profesional/intelektuale atëherë konsiderohet se mund të mbulohet nga të njëjtit persona.

Pretendimi i tretë:

Sa i përket arsyes së tretë të eliminimit, Autoriteti Kontraktues eliminon për mos ofrim të diplomës Master, mirëpo vlen të theksohet se kërkesa për sqarim të ofertës nga AK, përdoret dhe mund të pranohet për dokumentet e ofruara të cilat në mënyrë objektive mund të vërtetohen se kanë qenë para hapjes së ofertave, andaj diploma master e cila është specifikuar në listë të stafit, në kontratë të punës dhe në CV mund të plotësohet e cila është e lëshuar në vitin 2019. **Pretendimi i OE ankues gjendet i qëndrueshëm.**

Citat neni 38.3 Sqarimi i tenderëve- Rregullorja për Prokurim Publik

38.3 Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkojë dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve.

Pretendimi i katërt:

Kërkesa 2.25 në dosje të tenderit është minimum 2 ekspert për mbrojtje nga zjarri të certifikuar nga AME, për të cilën kërkesë AK ka eliminuar se është ofruar vetëm një të kompletuar, ndërsa OE ankues pretendon se dy ekspertët posedojnë certifikata valide nga AME, dhe rrjedhimisht bazuar në shkresat e lëndës, ekzistojnë dy ekspertë të cilët kanë certifikatat nga AME për mbrojtje nga zjarri, ndërsa njëri Z, J.R përkundër që në CV është specifikuar edhe certifikata nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë, mirëpo nuk është e dëshmuar në ankesë, e cila mund të plotësohet sipas nenit 72 të LPP-së, ashtu siç është sqaruar edhe nga AK. **Pretendimi pjesërisht i bazuar.**

Pretendimi i pestë:

Arsyeja e pestë e eliminimit lidhur me kërkesën nr. 3 të dosjes së tenderit përkatësisht mos përfshirjen e pikës 3.7 – Shqyrtimet të rrufepritësit, ekspertja shqyrtuese sqaron se, në ofertën e OE ankues gjendet Certifikatat e Akreditimit, (Laboratori testues i akredituar), ku në pjesën e parametrave testues emërtimi i saktë i kërkuar nuk është i shënuar, mirëpo në këtë aneks janë 17 parametra, dhe meqë po i njëjti OE posedon gjithashtu edhe Autorizimin nga

AME lidhur me Punët e testimit të rezistencës së tokëzimit në instalimet rrufepritëse, atëherë ky pretendim rekomandohet që në rivlerësim të sqarohet me organet kompetente lidhur me këtë parametër. **Pretendimi gjendet pjesërisht i bazuar.**

Pretendimi i gjashtë:

Arsyeja e gjashtë e eliminimit lidhur me marrëveshjen e konzorciumit.

Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin e gjashtë sqaron se, bazuar në Rregulloren për Prokurim Publik 001/2022 neni 26 Grupi i Operatorëve Ekonomik, përkatësisht paragrafi 15

26.15 Kurdo që Operatorët Ekonomik marrin pjesë si grup, grupi i operatorëve ekonomik së bashku me ofertën e tyre duhet të ofrojë një Marrëveshje për themelimin e grupit, në të cilën anëtarët e grupit do t'i përcaktojnë të drejtat dhe përgjegjësitë, si dhe të gjitha veprimet procedurale që duhet t'i kryej lideri i grupit në emër të grupit. Autoritetet Kontraktuese duhet të vendosin këtë kërkesë në Dosjen e Tenderit, si dhe formën standarde të marrëveshjes të hartuar dhe miratuar nga KRPP.

Për kundër kërkesës në dosje të tenderit pika 11.1 (e) ku AK ka përcaktuar se, në rast të krijimit të grupeve, duhet të përdoret formulari standard i paraqitur te Aneksi 7, **ndërsa** në ofertën e OE ankues gjendet marrëveshja e konzorciumit **mirëpo** është e përpiluar në një formë tjetër, kjo marrëveshje e cila gjithashtu ka të bashkangjitura edhe deklaratat veç e veç sipas Ligjit për Prokurim Publik neni 71, a.b.c. dhe d, vula, nënshkrimet, data, deklaratat nën betim etj.

Pretendimi i shtatë:

Sa i përket pretendimin të shtatë ekspertja shqyrtuese sqaron se, OE ankues si pasojë e mos dhënies së qasjes në ofertën e OE të rekomanduar nga AK, i njëjti nuk ka pretendime të qarta lidhur me ofertën e të rekomanduarit për kontratë, mirëpo AK konform nenit 10 dhe 11 të LPP-së, është i obliguar që të ofroj versionin e pastruar të dokumenteve, andaj rekomandohet AK që ti lejoj qasje të pastruar, me qëllim që të respektohet neni 6,7,10,11 i LPP-së, për faktin se i njëjti në mungesë të qasjes nuk ka mundur të parashtrojë pretendime ankimore kundër OE të rekomanduar. **Pretendimi i bazuar.**

Pretendimi i tetë:

Lidhur me pretendimin e tetë, ekspertja shqyrtuese sqaron se, sa i përket kërkesës 2.20 Inxhinier të diplomuar të Gjeologjisë, dy operatorët ekonomik ofertues kanë paraqitur të njëjtin inxhinier, dhe bazuar në dokumentet e ofruara në ofertën e OE ankues lidhur me këtë inxhinier, i njëjti së bashku me kontratën e bashkëpunimit ka të bashkangjitur një deklaratë, të cilat dëshmi rekomandohet AK që ti verifikoj konform nenit 52.7 të LPP-së. **Pretendimi i bazuar**

Pretendimi i nëntë:

Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin e nëntë sqaron se, Autoriteti Kontraktues me datë 27/08/2025 ka bërë hapjen e ofertave, raporti i vlerësimit është publikuar me datë 10/10/2025, ndërsa vendimi B58 është publikua me datë 09/12/2025, si e tillë bazuar në neni 40.3 të rregullores për Prokurim Publik, afati për vlerësimin e tenderit është jo më shumë se 30 ditë, vetëm në raste të jashtë zakonshme dhe komplekse mund të zgjatet shtesë edhe 20 ditë, mirëpo në rastin konkret vlerësimi i dy ofertave është bërë në afat me mbi 100 ditë, andaj **pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

40.3 Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nga komisioni vlerësues, dhe nxjerrja e Njoftimit mbi vendimin e AK nga ZPP, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Prosesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve.

Si përfundim, ekspertja shqyrtuese lidhur me ankesën e parashtruar të OE ankues për aktivitetin e prokurimit "Vlerësimi i rrezikshmërisë në vendet e punës në KEK sh.a" për konkluzion shpjegon se, Autoriteti Kontraktues me këtë aktivitet të prokurimit kërkon sipas Ankesit 1 specifikimet teknike të detyrueshme si mëposhtë:

VLERSIMI I RREZIKSHMËRISË NË VENDET E PUNËS NË

Divizioni për Prodhimin e Qymyrit

Qëllimi:

Përshkrimi sistematik i të gjitha aspekteve që ndërlidhen me vendin e punës për të vlerësuar se çka mund të shkaktoj lëndim ose dëmtim të punësuarve

- *Klasifikimi dhe sistemimi i punëve të cilat dëmtojnë shëndetin e punëtorit*

Masat që punëdhënësi duhet t'i ndërmerr për përmirësim të shkallës së sigurisë dhe shëndetit të punësuarve në mënyrë që rreziku dhe dëmtimet në tërësi të eliminohen, apo zvogëlohen në nivelin më të vogël të mundshëm.

Fusha e veprimit;

Fushëveprimet e këtij Projekti janë Vendet e punës me rrezikshmëri të parapara nga matjet mikro-

Klimatike të realizuara për kushtet e punës, faktorët të cilët kanë ndikim në shëndetin e punëtorëve si dhe metodologjia e veprimit për klasifikim të vendeve të punës më rrezikshmëri.

Karakteristikat veçuara në projekt janë:

Procesi i punës të punëdhënësit, metodologjia dhe evidencë nga siguria dhe shëndeti duke u bazuar

Në Ligjet, Rregulloret, Udhëzimet administrative të Republikës së Kosovës, Raportin e matjeve të dëmtuesve fiziko kimik, kushteve mikroklimatike në mesin punues.

Dhe si rrjedhojë për këtë aktivitet kanë ofertuar dy operator ekonomik, të cilët kanë ofruar çmimin si: I rekomanduari me 603 mijë euro ndërsa OE ankues si i eliminuar me ofertën 330 mijë euro, pra me një dallim afër 50 % të çmimit.

Tutje, pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, AK në dosje të tenderit ka përcaktuar kërkesat, duke kërkuar ekspert të ndryshëm për fusha të caktuara dhe me licenca adekuate, megjithatë, duke qenë se aktiviteti i prokurimit ka natyrë **shërbimesh intelektuale**, në të cilin projekt kërkohet analiza, identifikimi i rreziqeve, vlerësim profesional dhe raportimi sipas metodologjisë shkencore në baza vjetore të kërkuara, çka do të thotë se, nuk ka ndarje fizike të punëve gjatë realizimit të kontratës, nuk ka përqindje thelbësore në realizim të punëve, pra përgjegjësia është kolektive dhe profesionale e operatorit ekonomik ofertues. Atëherë e rëndësishme në këtë projekt është kualifikimi i tyre, projektet e kaluara si referenca të përfunduar dhe çmimi i ofruar. Prandaj si e tillë, marrë parasysh kriterit çmimi më i ulët i përgjegjshëm, me qëllim të respektimit të nenit 1,6,7,10, 11, 52.7,59.4,72, të Ligjit për Prokurim Publik, ekspertja shqyrtuese rekomandon panelin shqyrtues për rivlerësim të ofertave, duke rekomanduar Autoritetin Kontraktues që të kërkoj sqarime/verifikime në harmoni me Ligjin e Prokurimit Publik.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “N.N. Bli TERM”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Vlerësimi i rrezikshmërisë në vendet e punës në KEK sh.a.” me numër të prokurimit: “KEK-25-5008-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KOPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – N.N. Bli TERM

Blerina Huruglica

